

Emri i Lëndës : International Public Law							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 214	N/A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Gentjan Skara, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		E Drejta Ndërkombëtare Publike është tërësia e rregullave dhe normave të sjelljes ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Ky kurs është i konceptuar si i përbërë prej disa pjesëve, të cilat ofrojnë njohuri për sa i përket parimeve dhe burimeve të së drejtës ndërkombëtare, elementëve të domosdoshëm për ekzistencën e shtetit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, krijimin e organizatave joqeveritare dhe ndërqeveritare, institutet kryesore të së drejtës Ndërkombëtare të Detit, të së drejtës Ndërkombëtare të Traktateve, të së drejtës Diplomatike dhe Konsullore, të së drejtës Ndërkombëtare Humanitare, etj. Vëmendje e veçantë u kushtohet mekanizmave ndërkombëtarë për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare.					
Objektivat		Objektivi kryesor i studimit të lëndës E Drejta Ndërkombëtare Publike është të ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme mbi objektin dhe burimet e saj, evolucionin historik dhe raportin e saj me të drejtën e brendshme. Ndër të tjera, kursi synon të qartësojë natyrën e subjekteve të së drejtës ndërkombëtare publike dhe rolin e shtetit dhe organizatave ndërkombëtare si subjektet kryesore të saj. Në mënyrë të veçantë, një pjesë e kursit i dedikohet rolit të individit në periudhën e globalizmit, në të dy aspektet, si subjekt aktiv dhe pasiv i së drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu, lënda synon që të njohë studentët me kuadrin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.					
Konceptet Kryesore		1. E Drejta ndërkombëtare 2. E Drejta e Traktateve 3. Zakoni ndërkombëtar 4. Burimet e së drejtës ndërkombëtare 5. Shteti 6. Njohja Ndërkombëtare e shtetit 7. Njohja Ndërkombëtare e qeverisë 8. Imunitetit dhe Privilegjet 9. Përdorimi i forcës 10. Përgjësia e shteteve					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Hyrje në të drejtën ndërkombëtare Kjo temë trajton një vështrim të përgjithshëm mbi të drejtën ndërkombëtare në aspektin historik si dhe rëndësinë që ka e drejta ndërkombëtare. Gjatë leksionit, do të diskutohen konceptet kryesore me qëllim që studentet mos të kenë vështirësi. Gjithashtu, studentët do të njihen: i) mënyrën dhe formën e leksioneve; ii) detyrimet e frekuentimit si dhe iii) forma e vlerësimit. Literaturapërkatesë: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 35-60. 2. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013) 3-19. 3. Karta e OKB					
2		Burimet e së drejtës ndërkombëtare Në këtë javë studentët do të njihen me burimet e së drejtës ndërkombëtare. Neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të diskutohet duke shtruar pyetjet nëse: i) burimet e së drejtës ndërkombëtare dhe elementet e parashikuara; ii) neni 38 shpreh hierarki ndërmjet burimeve; iii) janë të mjaftueshme apo neni 38 duhet të rishikohet duke reflektuar edhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe burime të tjera soft. Literaturapërkatesë: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 61-136. 2. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013) 20-47 3. Statuti i GJNDsë					

3	E drejta e traktateve E Drejta e traktateve së bashku me të drejtën ndërkombëtare zakonore janë burimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare. Pas luftës së 2 botërore, gjithnjë e më shumë, shtetet po i materializojnë të drejtat dhe detyrimet nëpërmjet nënshkrimit të traktateve. Në këtë javë, studentët do të njihen më zhvillimin historik të së drejtës së traktatve; përkufizimin e traktatit; llojet e traktatve; mënyra e formimit dhe personat e autorizuar për të lidhur një traktat. Pas kuptimit dhe mënyrës së formimit të traktatit, studentët do të njihen me kuptimin dhe rendësinë e rezervës. Për ta kuptuar më mirë, disa shembuj nga traktate ndërkombëtare dhe raste nga Shqipëria do të diskutohen në klasë. Gjithashtu, në këtë temë do të trajtohet edhe rastet e pavlefshmërisë së një traktati. Literaturapërkatese: 1. Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve 1969 2. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 97-111
4	E drejta ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar: Sistemi Monist dhe Dualist Kjo temë trajton marrëdhënien e së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit ndërkombëtar. Është shumë e rëndësishme që studentët të njihen me mënyrën e penetrimit të së drejtës ndërkombëtare në sistemin ligjor kombëtar. Doktrina juridike njeh 2 lloje sistemesh: atë monist dhe dualist. Gjatë trajtimit të kësaj temë, do të analizohet se çfarë sistemi ka miratuar Shqipëria dhe se si normat ndërkombëtare marrin vlerë juridike. Literaturapërkatese: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 137-167 2. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013) 48-114. 3. Neni 116; 122 dhe 123 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar 1998, ndryshuar për herë të fundit në 2016.
5	Subjektiviteti juridik dhe shteti dhe njohja ndërkombëtare Kjo temë trajton personalitetin juridik të shtetit si dhe elementet e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare. Disa autorë konsiderojnë se elementët e shtetit janë: i) territori; ii) popullsia; iii) pushteti sovran; dhe iv) aftësia e një shteti për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera. Në këtë javë do të diskutohen këto elementë si dhe do të shikohet baza ligjore që përcakton këto elemente. Literaturapërkatese: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 168-200 2. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013), 115-142 3. Montevideo Convention on the Rights and Duties of States 1933
6	Njohja ndërkombëtare Në kuadër të sovranitetit, element përbërës konstitutiv i shtetit është njohja nga ana e shteteve të tjerë. (shek.XVIII-XIX) Akti i njohjes së një shteti nga shtetet e tjerë është ai që krijon një shtet të ri dhe i jep atij personalitet juridik, dhe jo procesi nëpërmjet të cilit ai ka fituar pavarësi. Kështu, shtetet e reja në komunitetin ndërkombëtar krijohen si subjekte me të drejta të plota të së drejtës ndërkombëtare si rrjedhojë e vullnetit dhe miratimit të shteteve tashmë ekzistuese. Literaturapërkatese: 1. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013), 143-165
7	Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 Ky leksion trajton zhvillimin historik të së drejtës diplomatike dhe materializimin e saj nëpërmjet Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike 1961. Leksioni trajton rëndësinë e Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike 1961 dhe identifikon normat zakonore të cilat janë materializuar në Konventë. Gjithashtu leksioni trajton edhe rëndësinë që kjo Konventë ka në ditët e sotme. Literatura përkatese: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 750-752 2. Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961
8	Imunitetet nga juridiksioni shtetëror Si rregull juridiksioni i një shteti brenda territorit të vet është i plotë dhe i pakufizuar. Megjithatë ekziston edhe një normë e së drejtës ndërkombëtare që një shtet i huaj gëzon të drejtën e disa imuniteteve nga ushtrimi i këtij juridiksioni, normë që në përgjithësi njihet si parimi i imunitetit shtetëror. Në këtë leksion do të diskutohet nocioni i përgjithshëm i imunitetit dhe argumentimi i tij në të drejtën ndërkombëtare. Literaturapërkatese: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 244-282.
9	provim gjysmefinal
10	E drejta e detit: Konventat dhe rendesia Kjo temë trajton të drejtën e detit. Së pari do të shpjegohet zhvillimi historik i së drejtës së detit duke iu referuar autorit të shquar Hugo Grotius. Me pas do të trajtohet konventat kryesore dhe rëndësia e tyre. Gjatë trajtimit të leksionit, një theks të vecantë do t'iu kushtohet normave zakonore të materializuara në konventa. Literatura përkatese: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 283-287. 2. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 553-556. 3. Konventa e vitit 1982 për të Drejtën e Detit

11	Përgjegjësia e shteteve Në këtë javë do të trajtohet përgjegjësia ndërkombëtare e shteteve. Përgjegjësia ndërkombëtare është çdo herë raport i shtetit me shtet, kur shteti që ka pësuar dëm kërkon satisfaksion (kënaqje). Që një shtet të thirret në përgjegjësi ndërkombëtare e domosdoshme është që të përmbushen disa kushte, të quajtura si elemente të përgjegjësisë së shteteve, edhe atë: i) të ekzistojë veprimi ose mosveprimi (lëshimi), me të cilin cenohet ndonjë detyrim i përcaktuar me normat e së drejtës ndërkombëtare (traktat ndërkombëtar, zakon ndërkombëtar) që është në fuqi në shtetin përgjegjës për aktin dhe shtetin e dëmtuar nga ai akt; ii) veprimi i paligjshëm duhet t'i mvishet shtetit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare; iii) me aktin e paligjshëm duhet që të jetë shkaktuar dëmi; dhe iv) duhet të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që parashihen nga e drejta e brendshme për të fituar kënaqje. Literaturapërkatese: 1. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013), 539-589 2. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 324-362
12	Përdorimi i forcës Bazuar në nenin 2 (4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara 'Të gjithë anëtarët ndalojnë në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare çdo kërcënim apo pëdorim dhune, që drejtohet kundër paprekshmërisë territoriale apo pavarësisë politike të një shteti ose që bie ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.' Ky parim tani konsiderohet si një pjesë e ligjit zakonor ndërkombëtar, dhe ka efektin e ndalimit të përdorimit të forcës së armatosur, përveç: i) veprimet kolektive të parashikuara në nenet 24 dhe 25, dhe Kapitullin VII të Kartës dhe ii) vetmbrojtja (neni 51). Literaturapërkatese: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 404 - 441
13	E drejta ndërkombëtare humanitare Në këtë temë do të trajtohet E drejta ndërkombëtare humanitare (DNH) e cila është një grup rregullash për arsye humanitare, qëllimi për të kufizuar pasojat e konflikteve të armatosura. DNH mbron ata të cilët nuk kanë ose nuk marrin pjesë në armiqësi dhe kufizon mjeteve dhe metodave të luftimit. DNH është pjesë e së drejtës ndërkombëtare, që në fakt rregullon marrëdhëniet ndërmjet shteteve. E drejta ndërkombëtare është implementuar nëpërmjet marrëveshjeve midis Shteteve - traktateve apo konventave, nëpërmjet rregullave zakonore të cilat janë të bazuara në praktikën e suksesshme të këtyre vendeve për të futur rregulla si ligjërsh të detyrueshme, por edhe nga parimet bazë. DNH aplikohet gjatë konflikteve të armatosura. Megjithatë, DNH nuk e rregullon situatën, kur një shtet mund të përdor forcën: ai është i qeverisur nga një pjesë e rëndësishme, por në mënyrë të qartë distinktiran së drejtës ndërkombëtare, e cila është e përfshira në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Gjatë leksionit, do të trajtohet origjina, natyra dhe kodifikimi i DNH. Gjithashtu do të diskutohet nëse DNH aplikohet në praktikë apo jo. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edn, Cambridge University Press 2008) 1167-1203.
14	Të drejtat e njeriut I Në këtë javë do të trajtohet kuadri ligjor i të drejtave të njeriut. Një rëndësi te vecantë do ti kushtohet Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 në Palais de Chaillot, Paris. Gjithashtu do të diskutohet rëndësia e kësaj Deklarate dhe impakti që kanë rëndet juridike kombëtare të shteteve anëtare. Të një rëndësi të vecantë do të kushtohet dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, me dy Protokolle opsionale. Këto dy Konventa, të cilat shpesh dallojnë më tej të drejtat e njeriut, u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në vitin 1966. Në vitin 1976, pasi Konventa ishte ratifikuar nga më shumë shtete anëtare për të hyrë në fuqi dhe qysh nga ky moment Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut mori fuqinë ligjore ndërkombëtare. Literaturapërkatese: 1. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law (8th edition, OUP 2013), 634 - 670 2. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1949) 3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 4. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
15	Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore Në përputhje me nenin 2(3) të Statutit të OKB së të gjithë anëtarët 'do të rregullojnë mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore, në mënyrë që të mos rezikohet paqja, siguria dhe drejtësia ndërkombëtare'. Në këtë leksion do të diskutohet rreth metodave kryesore efektive për zgjidhjen e konflikteve sic janë: ndërhyrja e një pale të tretë, grupet e synuara, negociatat, arbitrazhi, ndërmjetësimi. Këto metoda janë konsideruar funksionale në varësi të qasjes së palëve të përfshira në konflikt, ashtu edhe të atyre të përfshira në zgjidhjen e konflikteve. Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 363-403.
16	Final Exam

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AHS 2010) • 2. James Crawford, Brownlie's Principles of Public International Law(8th edition, OUP 2013) • 3. Malcolm Evans, Blackstone's International Law Documents (12th edition, OUP 2015)		
Referenca të tjera			
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të kenë përvetësuar njohuri të përgjithshme mbi të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe zbatimin praktik të normave të saj		
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të identifikojnë dhe të zbatojnë parimet ndërkombëtare ligjore relevante për çështjet aktuale dhe ngjarjet në politikën globale.		
3	Studentët do të mund të marrin informacion lidhur me me rregullat themelore dhe institucionet në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe problemet e hasura në zbatimin e tyre.		
4	Lënda do të përgatisë studentët për një karrierë në organizatat ndërkombëtare me trajnimin e tyre në strukturën dhe kompetencat e organizatave ndërkombëtare institucionale.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	40
Kuize		0	0
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	12	12
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.04
ECTS			5.00